



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 144

Tiranë – E enjte, 5 tetor 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 72/2023, datë 14.9.2023	Për miratimin e rezolutës nr. 463 (2022) të bordit drejtues të CEB, “Rritja e kapitalit të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB)” 16047
Dekret i Presidentit nr. 260, datë 2.10.2023	Për shpallje ligji..... 16052
Ligj nr. 73/2023, datë 14.9.2023	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Sllovakisë për eliminimin e tatimit të dyfishtë, në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe parandalimin dhe shmangien e evazionit tatimor..... 16052
Dekret i Presidentit nr. 261, datë 2.10.2023	Për shpallje ligji..... 16065
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 14, datë 28.9.2023	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH..... 16065
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec nr. (1185)-234, datë 19.12.2022	Për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ylli Braho..... 16066



LIGJ
Nr. 72/2023

PËR MIRATIMIN E REZOLUTËS NR.
463 (2022) TË BORDIT DREJTUES TË
CEB, “RRITJA E KAPITALIT TË
BANKËS PËR ZHVILLIM TË
KËSHILLIT TË EUROPËS (CEB)”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet rezoluta nr. 463 (2022) e Bordit Drejtues të CEB-it, “Rritja e kapitalit të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB)”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Rregullat dhe autoriteti kompetent për realizimin e rritjes së përgjithshme të kapitalit të Republikës së Shqipërisë në Bankën për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB) përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.9.2023.

Shpallur me dekretin nr. 260, datë 2.10.2023, të
Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj

/Logoja e Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB)/

Banka për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB)
Guvernaori

Ambasadrit Dastid KORESHI
Përfaqësues i përhershëm i Shqipërisë në
Këshillin e Evropës
/ Adresa /
2, Rue Waldteufel
F-67000 Strasbourg
Strasbourg

Paris, 15 dhjetor 2022

Rritja e kapitalit të Bankës për Zhvillim të
Këshillit të Europës (CEB)

I nderuar Ambasador,

Më 2 dhjetor 2022, Bordi Drejtues i Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB) miratoi rezolutën 463 (2022), që aprovon një rritje të kapitalit të nënshkruar të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB) në shumën 4.25 miliardë euro (shihni shtojcën 1).

Në zbatim të kësaj rezolute, Shqipëria ftohet të nënshkruajë në certifikatat e reja pjesëmarrëse me vlerë 10,386,000 euro. Rezoluta e mësipërme cakton përqindjen e kapitalit të paguar për këtë rritje të kapitalit në 28,24% të kapitalit të nënshkruar. Kapitali që do të paguajë Shqipëria është 2,933,006 euro. Shtojca 2 e kësaj letre përmban një tabelë që tregon, për të gjitha shtetet anëtare, gjendjen e kapitalit para dhe pas rritjes së kapitalit të nënshkruar plotësisht.

Periodha e nënshkrimit fillon në datën e rezolutës së Bordit Drejtues dhe zgjat deri më 31 dhjetor 2023. Për të nënshkruar në certifikatat e reja pjesëmarrëse, Shqipëria duhet të dërgojë një konfirmim të nënshkrimit të saj në CEB, në formën e një letre standarde (shihni shtojcën 3).

Rritja e kapitalit do të hyjë në fuqi në fund të muajit kalendarik ku të jenë regjistruar 67% e certifikatave pjesëmarrëse të ofruara, por mundësia për nënshkrim për rritjen e kapitalit do të vazhdojë deri në fund të periudhës së lartpërmendur të nënshkrimit.

Kapitali i paguar i lartpërmendur duhet t'i transferohet CEB-it në përputhje me kushtet e rezolutës së Bordit Drejtues. Siç jeni në dijeni, do t'ju isha mirënjohës nëse letra e nënshkrimit do të



cilësonte periudhën e parashikuar për pagesën e kapitalit të paguar, në përputhje me dispozitat e rezolutës.

Pagesat duhet të kryhen në llogarinë e mëposhtme:

DEUTSCHE BANK FRANKFURT
BIC: CEFPRPPXXX
KODI IBAN: DE 44 5007 0010 0928 7384 00

Pas marrjes së letrës së nënshkrimit, do t'ju jepen detaje të mëtejshme mbi pagesën. Nëse do të keni nevojë për informacione të mëtejshme lidhur me këtë fazë, ju lutem, mos hezitoni të kontaktoni:

Z. Rafael Ruisanchez, drejtor i Drejtorisë së Riskut dhe Kontrollit, në adresën elektronike (e-mail) Rafael.ruisanchez@coebank.org, për çdo pyetje në lidhje me pagesat e kësteve dhe çështje të tjera operative,

Z. Jan de Bel, këshilltar i përgjithshëm, në adresën elektronike (e-mail) jan.debel@coebank.org, për çdo pyetje ligjore.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në këtë rritje të kapitalit do të forcojë qëndrueshmërinë financiare të Bankës, duke mbështetur kështu misionin e saj për të promovuar kohezionin social në të gjithë Evropën.

Me respekt,
Carlo Monticelli
Guvernator

/ nënshkrimi /

Kopje për dijeni:

Znj. Adela Xhemali, anëtare AC, zëvendës-ministër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Znj. Christiane Schimeck, kryetare e Sekretariatit të Marrëveshjes së Pjesëshme për Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës

Z. Rafael Ruisanchez, drejtor i Drejtorisë së Riskut dhe Kontrollit

Bashkëlidhur:

Shtojca 1: Rezoluta /vendimi e/i Bordit Drejtues 463 (2022)

Shtojca 2: Gjendja e kapitalit para/pas rritjes së kapitalit; kapitali për t'u nënshkruar/ paguar

Shtojca 3: Letra standarde që shtetet anëtare duhet të nënshkruajnë për rritjen e kapitalit

Faqe | 16048

Adresa:

55, Avenue Kleber, France -75116, Paris

Tel: +33 1 47 55 55 00

Faks: +33 1 47 55 03 38

SWIFT: CEFPRPP

www.coebank.org

Shtojca 1. Rezoluta e Bordit Drejtues 463 (2022)

/Logoja e Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës(CEB)/
Banka për Zhvillim të Këshillit të Evropës (CEB)

/ Logoja e Këshillit të Evropës /
Këshilli i Evropës

Faqe 1

Rezoluta (vendimi) e/i Bordit Drejtues REZOLUTA 463 (2022) për rritjen e kapitalit të Bankës

Strasbourg, 2 dhjetor 2022CD PV/ 233/2022

Bordi Drejtues,

Duke pasur parasysh nenin IV, paragrafi 2, si dhe nenin IX, paragrafët 3.1.d dhe 3.2, të Statutit të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës,

Duke pasur parasysh rezolutën 1647 (2022) të Këshillit Administrativ,

Duke pasur parasysh memorandumun e guvernatorit për miratimin e rritjes së kapitalit të CEB-it (CD/233/1845/2022), si dhe Kuadrin Strategjik 2023-2027 (CD/233/1841/2022).

Pas shqyrtimit dhe diskutimit,

VENDOSI:

- të rrisë kapitalin e nënshkruar të bankës me një shumë maksimale prej 4.25 miliardë eurosh;

- të përcaktojë pjesën e kapitalit të paguar për rritjen e kapitalit në 28,24% të kapitalit të nënshkruar për secilin shtet anëtar nënshkruar (që korrespondon me një shumë maksimale prej 1.2 miliardë eurosh kapital të paguar) që do të paguhet në katër këste vjetore të barabarta;

- të përcaktojë dhe të sigurojë një periudhë nënshkrimi apo regjistrimi që fillon nga data e kësaj rezolute deri më 31 dhjetor 2023;



- të përcaktojë dhe të sigurojë që rritja e kapitalit të hyjë në fuqi në fund të muajit kalendarik në të cilin janë regjistruar të paktën 67% e certifikatave pjesëmarrëse të ofruara. Shtetet anëtare që janë regjistruar, duhet të paguajnë këstin e parë nga katër këstet vjetore të lartpërmendura deri në fund të muajit kalendarik që pason datën kur rritja e kapitalit hyn në fuqi. Për shtetet anëtare që regjistrohen vetëm pas datës efektive të rritjes së kapitalit, por përpara përfundimit të periudhës së nënshkrimit, këstet e para vjetore të lartpërmendura do të paguhet deri në fund të muajit kalendarik që pason datën e nënshkrimit të shtetit anëtar përkatës. Për të gjitha shtetet anëtare nënshkruese, këstet pasuese vjetore duhet të paguhet deri më 31 korrik 2024 dhe për vitet në vijim;

- të lejojë, me raste përjashtimore, një shtet anëtar nënshkrues që nuk është i aftë të paguajë këstin e parë në kohën e duhur, dhe që informon Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës në përputhje me rrethanat, të paguajë këstin e parë sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast në afatin e caktuar për këstin e dytë;

- të lejojë një shtet anëtar, sapo të ketë nënshkruar për rritjen e kapitalit, që në çdo moment derisa të ketë paguar të katër këstet, të paguajë përpara datës/ave përkatëse të caktuar/a, një ose disa ose të gjitha këstet që do të paguhet nga ky shtet anëtar. Nëse një shtet anëtar kryen një parapagim të tillë përpara hyrjes në fuqi të rritjes së kapitalit dhe nëse rritja e kapitalit nuk hyn në fuqi, Banka do t'i kthejë shumat e parapaguara shtetit anëtar përkatës pa vonesa të panevojshme pas përfundimit të periudhës së nënshkrimit.

Shtojca 3. Letër standarde për shtetet anëtare për nënshkrimin e rritjes së kapitalit

Letër me kokë e shtetit anëtar

Banka për Zhvillim të Këshillit të Evropës (CEB)

Guvernatori Carlo Monticelli
Adresa: 55, Avenue Kleber
F-75116 Paris

/ Vendi, data /

I nderuar Guvernator,

Në vijim të rezolutës 463(2022), të datës 2 dhjetor 2022, të Bordit Drejtues së Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës (CEB) për rritjen e

kapitalit të nënshkruar të Bankës me një shumë maksimale prej 4.25 miliardë eurosh, Shqipëria nënshkruan certifikatat pjesëmarrëse për një shumë prej 10,386,000 eurosh (që korrespondon me një shumë kapitali të paguar prej 2,933.006 eurosh).

Gjithashtu, konfirmoj se janë plotësuar të gjitha kushtet për këtë nënshkrim dhe vërej se regjistrimi i këtyre certifikatave të reja do të bëhet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në rezolutën e Bordit Drejtues.

[Më specifikisht, Shqipëria synon të paguajë kapitalin e paguar si më poshtë [përcaktoni planin e pagesave të synuara, në përputhje me rezolutën e lartpërmendur].

Me respekt,
/ nënshkrimi /
/ emri /
/ pozicioni /

Kopje për dijeni:

Znj. Christiane Schimeck, kryetare e Sekretariatit të Marrëveshjes së Pjesëshme për Bankën e Zhvillimit të Këshillit të Evropës (CEB)

Këshilli i Evropës
F-67075 Strasbourg Cedex

Z. Rafael Ruisanchez, drejtor i Drejtorisë së Riskut dhe Kontrollit

Adresa: 55, Avenue Kleber
F-75116 Paris



Shtojca 2. Situata e kapitalit para/pas rritjes së kapitalit, kapitali për t'u nënshkruar/paguar

Situata e kapitalit si dhe rritja e kapitalit e Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës CEB															
	Situata në datën 31.10.2022					Rritja e propozuar për rritje					Situata pas rritjes * së kapitalit				
	Kapitali i nënshkruar		Kapital i pathirur	Kapitali i paguar		Kapitali i nënshkruar		Kapital i pathirur	Kapitali i paguar		Kapitali i nënshkruar		Kapital i pathirur	Kapitali i paguar	
	kapitali i nënshkruar	% e kapitalit të nënshkruar	Kapital i pathirur (për tu derdhur) 3=1-4	kapitali i paguar	%5=(4/1)	kapitali i nënshkruar	% e kapitalit të nënshkruar	Kapital i pathirur (për tu derdhur) 8=6-9	kapitali i paguar	% 10=(9/6)	kapitali i nënshkruar	% e kapitalit të nënshkruar	Kapital i pathirur (për tu derdhur) 8=6-9	kapitali i paguar	% 10=(9/6)
Euros	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
France	915 770 000	16.720%	814 114 000	101 656 000	11.101%	710 593 000	16.720%	509 921 537	200 671 463	28.240%	1 626 363 000	16.720%	1 324 035 537	302 327 463	18.589%
Gjermani	915 770 000	16.720%	814 114 000	101 656 000	11.101%	710 593 000	16.720%	509 921 537	200 671 463	28.240%	1 626 363 000	16.720%	1 324 035 537	302 327 463	18.589%
Itali	915 770 000	16.720%	814 114 000	101 656 000	11.101%	710 593 000	16.720%	509 921 537	200 671 463	28.240%	1 626 363 000	16.720%	1 324 035 537	302 327 463	18.589%
Spanjë	597 257 000	10.905%	530 958 000	66 299 000	11.101%	463 443 000	10.905%	332 566 697	130 876 303	28.240%	1 060 700 000	10.905%	863 524 697	197 175 303	18.589%
Turqi	388 299 000	7.089%	345 197 000	43 102 000	11.100%	301 301 000	7.089%	216 213 598	85 087 402	28.240%	689 600 000	7.089%	561 410 598	128 189 402	18.589%
Holandë	198 813 000	3.630%	176 743 000	22 070 000	11.101%	154 269 000	3.630%	110 703 434	43 565 566	28.240%	353 082 000	3.630%	287 446 434	65 635 566	18.589%
Belgrike	164 321 000	3.000%	146 083 000	18 238 000	11.099%	127 505 000	3.000%	91 497 588	36 007 412	28.240%	291 826 000	3.000%	237 580 588	54 245 412	18.588%
Greqi	164 321 000	3.000%	146 083 000	18 238 000	11.099%	127 505 000	3.000%	91 497 588	36 007 412	28.240%	291 826 000	3.000%	237 580 588	54 245 412	18.588%
Portugali	139 172 000	2.541%	123 724 000	15 448 000	11.100%	107 991 000	2.541%	77 494 342	30 496 658	28.240%	247 163 000	2.541%	201 218 342	45 944 658	18.589%
Suedi	139 172 000	2.541%	123 724 000	15 448 000	11.100%	107 991 000	2.541%	77 494 342	30 496 658	28.240%	247 163 000	2.541%	201 218 342	45 944 658	18.589%
Poloni	128 260 000	2.342%	114 023 000	14 237 000	11.100%	99 524 000	2.342%	71 418 422	28 105 578	28.240%	227 784 000	2.342%	185 441 422	42 342 578	18.589%
Danimarkë	89 667 000	1.637%	79 712 000	9 955 000	11.102%	69 577 000	1.637%	49 928 455	19 648 545	28.240%	159 244 000	1.637%	129 640 455	29 603 545	18.590%
Finlande	69 786 000	1.274%	62 039 000	7 747 000	11.101%	54 151 000	1.274%	38 858 758	15 292 242	28.240%	123 937 000	1.274%	100 897 758	23 039 242	18.589%
Norvegji	69 786 000	1.274%	62 039 000	7 747 000	11.101%	54 151 000	1.274%	38 858 758	15 292 242	28.240%	123 937 000	1.274%	100 897 758	23 039 242	18.589%
Bullgari	62 459 000	1.140%	55 526 000	6 933 000	11.100%	48 465 000	1.140%	34 778 484	13 686 516	28.240%	110 924 000	1.140%	90 304 484	20 619 516	18.589%
Rumani	59 914 000	10.94%	53 264 000	6 650 000	11.099%	46 490 000	1.094%	33 361 224	13 128 776	28.240%	106 404 000	1.094%	86 625 224	19 778 776	18.588%
Zvicër	53 824 000	0.983%	43 229 000	10 595 000	19.685%	41 765 000	0.983%	29 970 564	11 794 436	28.240%	95 589 000	0.983%	73 199 564	22 389 436	23.423%
Irlandë	48 310 000	0.882%	42 948 000	5 362 000	11.099%	37 486 000	0.882%	26 899 954	10 586 046	28.240%	85 796 000	0.882%	69 847 954	15 948 046	18.588%
Hungari	44 788 000	0.818%	39 816 000	4 972 000	11.101%	34 753 000	0.818%	24 938 753	9 814 247	28.240%	79 541 000	0.818%	64 754 753	14 786 247	18.589%
Republika Çeke	43 037 000	0.786%	38 260 000	4 777 000	11.100%	33 395 000	0.786%	23 964 252	9 430 748	28.240%	76 432 000	0.786%	62 224 252	14 207 748	18.589%
Luksemburg	34 734 000	0.634%	30 878 000	3 856 000	11.102%	26 952 000	0.634%	19 340 755	7 611 245	28.240%	61 686 000	0.634%	50 218 755	11 467 245	18.590%
Serbi	25 841 000	0.472%	22 973 000	2 868 000	11.099%	20 051 000	0.472%	14 388 598	5 662 402	28.240%	45 892 000	0.472%	37 361 598	8 530 402	18.588%
Kroaci	21 376 000	0.390%	19 003 000	2 373 000	11.101%	16 587 000	0.90%	11 902 831	4 684 169	28.240%	37 963 000	0.90%	30 905 831	7 057 169	18.590%
Qipro	19 882 000	0.363%	17 676 000	2 206 000	11.095%	15 427 000	0.363%	11 070 415	4 356 585	28.240%	35 309 000	0.363%	28 746 415	6 562 585	18.586%
Republika Sllovake	18 959 000	0.346%	16 584 000	2 105 000	11.103%	14 711 000	0.346%	10 556 614	4 154 386	28.240%	33 670 000	0.346%	27 410 614	6 259 386	18.590%
Shqipëri	13 385 000	0.244%	11 899 000	1 486 000	11.102%	10 386 000	0.244%	7 452 994	2 933 006	28.240%	23 771 000	0.244%	19 351 994	4 419 006	18.590%
Letoni	12 808 000	0.234%	11 387 000	1 421 000	11.095%	99 380 000	0.234%	7 131 509	2 806 491	28.240%	22 746 000	0.234%	18 518 509	4 227 491	18.586%
Estoni	12 723 000	0.232%	11 311 000	1 412 000	11.98%	9 872 000	0.232%	7 084 147	2 787 853	28.240%	22 595 000	0.232%	18 395 147	4 199 853	18.588%
Maqedonia e Veriut	12 723 000	0.232%	11 311 000	1 412 000	11.098%	9 872 000	0.232%	7 084 147	2 787 853	28.240%	22 595 000	0.232%	18 395 147	4 199 853	18.588%
Lituani	12 588 000	0.230%	11 191 000	1 397 000	11.098%	9 768 000	0.230%	7 009 517	2 758 483	28.240%	22 356 000	0.230%	18 200 517	4 155 483	18.588%
Sloveni	12 295 000	0.224%	10 930 000	1 365 000	11.102%	9 540 000	0.224%	6 845 904	2 694 096	28.240%	21 835 000	0.224%	17 775 904	4 059 096	18.590%
Islandë	10 144 000	0.185%	9 018 000	1 126 000	11.100%	7 871 000	0.185%	5 648 230	2 222 770	28.240%	18 015 000	0.185%	14 666 230	3 348 770	18.589%
Malta	10 144 000	0.185%	9 018 000	1 126 000	11.100%	7 871 000	0.185%	5 648 230	2 222 770	28.240%	18 015 000	0.185%	14 666 230	3 348 770	18.589%
Gjeorgji	9 876 000	0.180%	8 780 000	1 096 000	11.098%	7 663 000	0.180%	5 498 969	2 164 031	28.240%	17 539 000	0.180%	14 278 969	3 260 031	18.587%
Bosnje-Hercegovinë	9 689 000	0.177%	8 614 000	1 075 000	11.095%	7 518 000	0.177%	5 394 917	2 123 083	28.240%	17 207 000	0.177%	14 008 917	3 198 083	18.586%
Mali Zi	6 584 000	0.120%	5 853 000	731 000	11.103%	5 109 000	0.120%	3 666 218	1 442 782	28.240%	11 693 000	0.120%	9 519 218	2 173 782	18.590%
Kosova	6 559 000	0.120%	5 831 000	728 000	11.099%	5 089 000	0.120%	3 651 866	1 437 134	28.240%	11 648 000	0.120%	9 482 866	2 165 134	18.588%
Moldavi	5 488 000	0.100%	4 878 000	610 000	11.115%	4 258 000	0.100%	3 055 541	1 202 459	28.240%	9 746 000	0.100%	7 933 541	1 812 459	18.597%
Andora	4 925 000	0.090%	4 378 000	547 000	11.107%	3 822 000	0.090%	2 742 667	1 079 333	28.240%	8 747 000	0.090%	7 120 667	1 626 333	18.593%
San Marino	4 867 000	0.089%	4 206 000	661 000	13.581%	3 777 000	0.089%	2 710 375	1 066 625	28.240%	8 644 000	0.089%	6 916 375	1 727 625	19.986%



Litenshtejn	2 921 000	0.053%	2 374 000	547 000	18.726%	2 267 000	0.053%	1 626 799	640 201	28.240%	5 188 000	0.053%	4 000 799	1 187 201	22.884%
Selia e Shenjtë (Vatikan)	137 000	0.003%	107 000	30 000	21.898%	106 000	0.003%	76 066	29 934	28.240%	243 000	0.003%	183 066	59 934	24.664%
TOTALI (gjithsej)	5 477 144 000	100.000	4 864 180 000	612 964 000	11.191%	4 249 996 000	100.000%	3 049 797 133	1 200 198 867	28.240%	9 727 140 000	100.000%	7 913 977 133	1 813 162 867	18.640%

* Situata pas rritjes së kapitalit duke supozuar se të gjitha vendet do të nënshkruajnë.



DEKRET

Nr. 260, datë 2.10.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 72/2023, “Për miratimin e rezolutës nr. 463 (2022) të Bordit Drejtues të CEB, ‘Rritja e kapitalit të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës (CEB)’”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ

Nr. 73/2023

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË SLOVAKISË PËR
ELIMINIMIN E TATIMIT TË
DYFISHTË, NË LIDHJE
ME TATIMET MBI TË ARDHURAT
DHE PARANDALIMIN DHE
SHMANGIEN E EVAZIONIT TATIMOR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Sllovakisë për eliminimin e tatimit të dyfishtë, në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe parandalimin dhe shmangien e evazionit tatimor, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Faqe | 16052

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.9.2023.

Shpallur me dekretin nr. 261, datë 2.10.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
SLOVAKISË PËR ELIMINIMIN E TATIMIT
TË DYFISHTË, NË LIDHJE ME TATIMET
MBI TË ARDHURAT DHE PARANDALIMIN
DHE SHMANGIEN E EVAZIONIT
TATIMOR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Sllovakisë, në vijim të referuara vetëm si “Shtete Kontraktuese”,

duke dëshiruar të zhvillojnë më tej marrëdhëniet e tyre ekonomike dhe të rrisin bashkëpunimin e tyre në çështjet tatimore;

duke synuar të eliminojnë tatimin e dyfishtë, në lidhje me tatimet mbi të ardhurat pa krijuar mundësi për mostatim ose tatim të reduktuar nëpërmjet evazionit ose shmangies së tatimeve, duke përfshirë nëpërmjet marrëveshjeve të tipit *treaty shopping* (praktika e strukturimit të një biznesi shumë-kombësh për të përfituar nga traktatet tatimore më të favorshme në dispozicion në juridiksione të caktuara), që synojnë lehtësirat e parashikuara në këtë Marrëveshje, për përfitim të tërthortë të rezidentëve të shteteve të treta,

kanë renë dakord si më poshtë:

Neni 1

Personat e mbuluar

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për personat që janë rezidentë të një ose dy Shteteve Kontraktuese.

2. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, të ardhurat e nxjerra nga ose nëpërmjet një subjekti ose angazhimi, që trajtohet si tërësisht ose pjesërisht transparente nga pikëpamja fiskale, sipas ligjit tatimor të secilit Shtet Kontraktues, konsiderohen të



ardhurat e një rezidenti të një Shteti Kontraktues, por vetëm në masën që të ardhurat trajtohen, për qëllime tatimi, nga ai Shtet Kontraktues, si të ardhura të një rezidenti të atij Shteti Kontraktues.

3. Kjo Marrëveshje nuk cenon në tatimin, nga një Shtet Kontraktues, të rezidentëve të tij, përveç në lidhje me përfitimet e dhëna sipas paragrafit 2, të nenit 9, dhe neneve 18, 19, 21, 22, 23 dhe 25.

Neni 2

Tatimet e përfshira

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për tatimet mbi të ardhurat të vendosura në emër të një Shteti Kontraktues ose nënndarjeve të tij politike ose të autoriteteve lokale, pavarësisht nga mënyra sesi vendosen.

2. Konsiderohen tatime mbi të ardhurat të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat totale ose mbi elemente të të ardhurave, duke përfshirë tatimet mbi të ardhurat e kapitalit nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme, si dhe tatimet mbi shumat totale të rrogave ose të pagave të paguara nga ndërmarrjet.

3. Tatimet ekzistuese për të cilat zbatohet Marrëveshja janë në veçanti:

a) në Republikën e Shqipërisë:

i. tatimet mbi të ardhurat, duke përfshirë tatimin mbi fitimin e korporatës, tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin e fitimeve të kapitalit nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme; dhe

ii. tatimi mbi aktivitetet e biznesit të vogël;

b) në Republikën sllovaqe:

i. tatimet mbi të ardhurat e individëve;

ii. tatimet mbi të ardhurat e personave juridikë.

4. Marrëveshja zbatohet edhe për çdo tatim të njëjtë ose kryesisht të ngjashëm që vendoset pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes si shtesë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese njoftojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim thelbësor në ligjet e tyre përkatëse tatimore.

Neni 3

Përkufizime të përgjithshme

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, nëse nga konteksti nuk kërkohet ndryshe:

a) termi “Shqipëri” nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe, nëse përdoret në kuptimin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si dhe çdo zonë përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, që në bazë të ligjeve të saj dhe në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, është një zonë brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtroje të drejtat e saj, në lidhje me shtratin e detit, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

b) termi “Republika Sllovaqe” nënkupton Republikën Sllovaqe dhe kur përdoret në kuptimin gjeografik, nënkupton territorin e saj, brenda së cilës Republika Sllovaqe ushtron të drejtat dhe juridiksionin e saj sovran, në përputhje me rregullat e së drejtës ndërkombëtare.

c) termi “person” përfshin një individ, shoqëri dhe çdo organizim tjetër personash;

d) termi “shoqëri” nënkupton një organizim korporativ ose subjekt që trajtohet si organ korporativ për qëllime tatimore;

e) termi “ndërmarrje” zbatohet për kryerjen e ndonjë biznesi;

f) termi “ndërmarrje e një Shteti Kontraktues” dhe “ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues” nënkupton përkatësisht një ndërmarrje të zhvilluar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrje të zhvilluar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues;

g) termi “trafik ndërkombëtar” nënkupton çdo transport me anije, avion, hekurudhë ose mjet rrugor, përveç kur anija, avioni, hekurudha ose mjeti rrugor operojnë vetëm ndërmjet vendeve në një Shtet Kontraktues;

h) termi “autoritet kompetent” nënkupton:

i. në Shqipëri, Ministria e Financave ose përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Financave;

ii. në Republikën sllovaqe, Ministria e Financave e Republikës Sllovaqe ose përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Financave;

i) termi “shtetas” në lidhje me një Shtet Kontraktues, nënkupton:

i. çdo individ që ka kombësinë ose shtetësinë e atij Shteti Kontraktues; dhe

ii. çdo person juridik, partneritet ose shoqatë, statusi i së cilës buron si i tillë nga ligjet në fuqi në atë Shtet Kontraktues.



j) termi “biznes” përfshin kryerjen e shërbimeve profesionale dhe aktiviteteve të tjera të një karakteri të pavarur.

k) termi “fond pensioni i njohur” i një Shteti Kontraktues nënkupton një subjekt ose angazhim të krijuar në atë Shtet Kontraktues, që trajtohet si një person i veçantë, sipas ligjeve tatimore të atij Shteti Kontraktues, dhe:

i. që është themeluar dhe funksionon ekskluzivisht ose pothuajse ekskluzivisht për të administruar ose siguruar përfitime pensioni dhe përfitime ndihmese ose të rastësishme për individët dhe që rregullohet si i tillë nga ai Shtet Kontraktues ose një nga nënndarjet e tij politike ose autoritetet vendore; ose

ii. që është themeluar dhe funksionon ekskluzivisht ose pothuajse ekskluzivisht për të investuar fonde në interes të subjekteve ose të marrëveshjeve të përmendura në nënndarjen “i”.

2. Në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, çdo term që nuk është përkufizuar në të, përveç ku konteksti e kërkon ndryshe, ose autoritetet kompetente bien dakord për një kuptim të ndryshëm në zbatim të dispozitave të nenit 23, ka kuptimin që ka në atë kohë sipas ligjit të atij Shteti Kontraktues, për qëllimet e tatimeve për të cilat zbatohet kjo Marrëveshje, ku çdo kuptim, sipas ligjeve të zbatueshme tatimore të atij Shteti Kontraktues ka përparësi ndaj kuptimit të dhënë atij termi sipas ligjeve të tjera të atij Shteti Kontraktues.

Neni 4 Rezidenti

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termi “rezident i një Shteti Kontraktues” nënkupton çdo person, i cili, sipas ligjeve të atij Shteti Kontraktues, u nënshtrohet tatimeve atje për shkak të vendbanimit, vendqëndrimit, vendit të menaxhimit ose një kriteri tjetër të një natyre të ngjashme dhe përfshin edhe atë Shtet Kontraktues ose çdo nënndarje politike apo autoritet të tij lokal, si dhe çdo fond pensioni të njohur të atij Shteti Kontraktues. Megjithatë, ky term nuk përfshin asnjë person që u nënshtrohet tatimeve në atë Shtet Kontraktues, në lidhje me të ardhurat nga burimet në atë Shtet Kontraktues.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, një individ është rezident në të dy Shtetet

Kontraktuese, atëherë statusi i tij përcaktohet si më poshtë:

a) konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit Kontraktues në të cilin ka banesë të përhershme në dispozicion; nëse ka një banesë të përhershme në dispozicion në të dyja Shtetet Kontraktuese, ai do të konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit Kontraktues, me të cilin ka marrëdhënie më të afërta personale dhe ekonomike (qendra e interesave jetike);

b) nëse Shteti Kontraktues ku ka qendrën e interesave të tij jetikë nuk mund të përcaktohet ose nëse nuk ka banesë të përhershme në dispozicion në asnjë Shtet Kontraktues, ai do të konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit në të cilin ka vendbanim të zakonshëm;

c) nëse ka vendbanim të zakonshëm në të dyja Shtetet Kontraktuese ose në asnjërin prej tyre, do të konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit Kontraktues nga i cili është shtetas;

d) nëse është shtetas i të dy Shteteve Kontraktuese ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do ta zgjidhin çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë;

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit I të këtij neni, një person i ndryshëm nga një individ, është rezident i të dyja Shteteve Kontraktuese, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të synojnë të përcaktojnë me marrëveshje të ndërsjellë Shtetin Kontraktues nga i cili ky person konsiderohet rezident për qëllime të Marrëveshjes, duke pasur parasysh vendin e menaxhimit të tij efektiv, vendin ku është themeluar ose ndryshe krijuar dhe faktorë të tjerë përkatës. Në mungesë të kësaj marrëveshjeje, ky person nuk ka të drejtë për kompensim dhe në një mënyrë të tillë që mund të dakordësohet nga autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese.

Neni 5 Selia e përhershme

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termi “seli e përhershme” nënkupton një vend fiks biznesi nëpërmjet, të cilit zhvillohet biznesi i një ndërmarrjeje në mënyrë të plotë ose të pjesshme.

2. Termi “seli e përhershme” përfshin, në veçanti:

- a) një vend menaxhimi;
- b) degë;



- c) zyrë;
- d) fabrikë;
- e) punishte; dhe

f) minierë, pus naftë ose gaz, gurore ose vend tjetër për nxjerrjen e burimeve natyrore.

3. Një kantier ndërtimi ose ndërtim ose instalim, si dhe aktivitete të mbikëqyrjes të lidhura me to, përbëjnë një seli të përhershme, por vetëm nëse vazhdon për më shumë se nëntë muaj.

4. Termi “seli e përhershme” përfshin, gjithashtu: ofrimin e shërbimeve, duke përfshirë shërbimet e konsulencës, nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ose nëpërmjet punonjësve ose personeli tjetër të angazhuar nga ndërmarrja për këtë qëllim, por vetëm nëse aktivitetet e kësaj natyre (vazhdojnë brenda territorit të Shtetit tjetër Kontraktues, për një periudhë ose periudha që në total përbëjnë më shumë se nëntë muaj brenda çdo periudhe dymbëdhjetë mujore.

5. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi “seli e përhershme” konsiderohet të mos përfshijë:

a) përdorimin e mjediseve vetëm për qëllime magazinimi ose ekspozimi të mallrave ose artikujve që i përkasin ndërmarrjes;

b) mbajtjen e një stoku mallrash ose artikujsh që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim magazinimi ose ekspozimi;

c) mbajtjen e një stoku mallrash ose artikujsh që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim të përpunimit nga një ndërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të blerjes së mallrave ose artikujve ose të mbledhjes së informacionit për ndërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të kryerjes nga ana e ndërmarrjes, të çdo aktiviteti tjetër për ndërmarrjen;

f) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët “a” deri “e”, me kusht që ky aktivitet ose në rastin e nënparagrafit “P”, aktiviteti i përgjithshëm i vendit fiks të biznesit, të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

6. Paragrafi 5 nuk zbatohet për një vend të caktuar biznesi, që përdoret ose mirëmbahet nga një ndërmarrje, nëse e njëjta ndërmarrje ose një ndërmarrje e lidhur ngushtë ushtron veprimtari biznesi në të njëjtin vend ose në një vend tjetër në të njëjtin Shtet Kontraktues dhe

a) ai vend ose vend tjetër përbën një secili të përhershme për ndërmarrjen ose ndërmarrjen e lidhur ngushtë sipas dispozitave të këtij neni; ose

b) aktiviteti i përgjithshëm që rezulton nga kombinimi i aktiviteteve të kryera nga dy ndërmarrje në të njëjtin vend, ose nga e njëjta ndërmarrje ose ndërmarrje të lidhura ngushtë në të dyja vendet, nuk është i një karakteri përgatitor ose ndihmës, me kusht që aktivitetet e biznesit të kryera nga dy ndërmarrje në të njëjtin vend, ose nga e njëjta ndërmarrje ose ndërmarrje të lidhura ngushtë në të dyja vendet, përbëjnë funksione plotësuese që janë pjesë e një operacioni koheziv biznesi.

7. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, por në bazë të dispozitave të paragrafit 8, kur një person vepron në një Shtet Kontraktues në emër të një ndërmarrjeje, kjo ndërmarrje do të konsiderohet që ka një seli të përhershme në atë shtet kontraktues në lidhje me çdo aktivitet që personi ndërmerr për ndërmarrjen, nëse një person i tillë:

a) zakonisht lidh kontrata, ose zakonisht luan rolin kryesor që çon në përfundimin e kontratave që lidhen në mënyrë rutinore pa modifikime materiale nga ndërmarrja, dhe këto kontrata janë:

i. në emër të ndërmarrjes; ose

ii. për transferimin e pronësisë, ose për dhënien e së drejtës për përdorim, të pronës në pronësi të asaj ndërmarrjeje ose që ndërmarrja ka të drejtë të përdorë; ose

iii. për ofrimin e shërbimeve nga ajo ndërmarrje, përveç nëse aktivitetet e këtij personi janë të kufizuara në ato të përmendura në paragrafin 5 të këtij neni, të cilat, nëse ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks të biznesit (përveç një vendi fiks të biznesit për të cilin do të zbatohet paragrafi 6), nuk do ta bënte këtë vend fiks biznesi një seli të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi; ose

b) personi nuk lidh zakonisht kontrata as nuk luan rolin kryesor që çon në përfundimin e kontratave të tilla, por zakonisht mban në atë Shtet Kontraktues një magazinë të mallrave ose artikujve nga të cilat ai person dërgon rregullisht mallra ose artikuj në emër të ndërmarrjes.

8. Paragrafi 7 nuk zbatohet kur personi që vepron në një Shtet Kontraktues në emër të një ndërmarrje të Shtetit tjetër Kontraktues ushtron biznes në Shtetin e përmendur së pari si agjent i pavarur dhe vepron për ndërmarrjen në rrjedhën e zakonshme të atij biznesi. Megjithatë, kur një person



vepron ekskluzivisht ose pothuajse ekskluzivisht në emër të një ose më shumë ndërmarrjeve me të cilat është i lidhur ngushtë, ai person nuk do të konsiderohet të jetë një agjent i pavarur, sipas kuptimit të këtij paragrafi, në lidhje me ndonjë ndërmarrje të tillë.

9. Për qëllimet e këtij neni, një person ose ndërmarrje është i lidhur ngushtë me një ndërmarrje nëse, bazuar në të gjitha faktet dhe rrethanat përkatëse, njëri kontrollon tjetrin ose të dy janë nën kontrollin e të njëjtëve persona ose ndërmarrje. Në çdo rast, një person ose ndërmarrje konsiderohet i lidhur ngushtë me një ndërmarrje, nëse njëra zotëron drejtpërdrejt ose tërthorazi më shumë se 50 për qind të interesit përfitues në tjetrën (ose, në rastin e një shoqërie, më shumë se 50 për qind të votave të përgjithshme dhe vlerës së aksioneve të shoqërisë ose interesit të kapitalit përfitues në shoqëri) ose nëse një person ose ndërmarrje tjetër zotëron drejtpërdrejt ose tërthorazi më shumë se 50 për qind të interesit përfitues (ose, në rastin e një shoqërie, më shumë se 50 për qind të votës së përgjithshme dhe vlerës së aksioneve të shoqërisë ose interesit të pronësisë përfituese në shoqëri) tek personi dhe ndërmarrja.

10. Për qëllimin e vetëm për të përcaktuar nëse është tejkaluar periudha nëntëmujore e përmendur në paragrafin 3:

a) kur një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues kryen aktivitete në Shtetin tjetër Kontraktues në një vend që përbën një vend ndërtimi ose ndërtim ose instalim ose veprimtari mbikëqyrëse, në lidhje me to dhe këto aktivitete kryhen gjatë një ose më shumë periudhave kohore që, në total, kalojnë 30 ditë pa i kaluar nëntë muaj; dhe

b) aktivitetet e lidhura kryhen në të njëjtin vend ndërtimi ose instalimi ose aktivitete mbikëqyrëse në lidhje me to gjatë periudhave të ndryshme kohore, secila më shumë se 30 ditë, nga një ose më shumë ndërmarrje të lidhura ngushtë me ndërmarrjen e përmendur së pari, këto periudha të ndryshme kohore do t'i shtohen periudhës kohore gjatë së cilës ndërmarrja e përmendur së pari ka kryer aktivitete në atë vend ndërtimi ose instalimi ose aktivitete mbikëqyrëse në lidhje me to.

11. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, një ndërmarrje sigurimi e një Shteti Kontraktues konsiderohet se ka seli të përhershme në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse mbledh primet në territorin e Shtetit tjetër Kontraktues ose siguron

rreziqe të vendosura në të nëpërmjet një personi, përveç agjentit që ka një status të pavarur, për të cilin zbatohet paragrafi 8 i këtij neni.

12. Fakti që një shoqëri e cila është rezidente e një Shteti Kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues ose që zhvillon biznes në atë Shtet tjetër Kontraktues (qoftë nëpërmjet një selie të përhershme ose ndryshe) nuk përbën në vetvete që një prej këtyre shoqërive është seli e përhershme e shoqërisë tjetër.

Neni 6

Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme

1. Të ardhurat që rrjedhin nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga prona e paluajtshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia ose pylltaria), që ndodhen në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë Shtet tjetër Kontraktues.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” ka kuptimin që ka sipas ligjit të Shtetit Kontraktues ku ndodhet prona në fjalë. Në çdo rast, termi përfshin pasurinë ndihmëse të pasurisë së paluajtshme, gjënë e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi dhe pylltari, të drejtat për të cilat zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm, në lidhje me pasurinë e paluajtshme, uzufuktin e pasurisë së paluajtshme dhe të drejtat për pagesa të ndryshueshme ose fikse si shpërblim për punën ose të drejtën për punë, depozitat minerare, burimet dhe pasuritë e tjera natyrore; anijet, avionët, hekurudha dhe mjetet rrugore nuk konsiderohen si pasuri e paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i drejtpërdrejtë, dhënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurisë së paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 të këtij neni zbatohen edhe për të ardhurat nga prona e paluajtshme e një ndërmarrjeje.

Neni 7

Fitimet e biznesit

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues janë të tatueshme vetëm në atë Shtet Kontraktues, përveç kur ndërmarrja zhvillon biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur atje. Nëse ndërmarrja zhvillon biznes si më sipër, fitimet e ndërmarrjes



mund të tatohen në Shtetin tjetër Kontraktues, por vetëm në masën që i atribuohet asaj selie të përhershme.

2. Në bazë të dispozitave të paragrafit 3 të këtij neni, kur një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues zhvillon biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur atje, fitimet të cilat mund të pritej të nxirrte nëse do të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe e ndarë, e përfshirë në aktivitete të njëjta ose të ngjashme, sipas kushteve të njëjta ose të ngjashme dhe që ka marrëdhënie tërësisht të pavarura me ndërmarrjen seli e përhershme e së cilës ajo është, në secilin Shtet Kontraktues i atribuohen asaj selie të përhershme.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme, lejohen si zbritje shpenzimet që janë kryer për qëllime të selisë së përhershme, duke përfshirë shpenzimet ekzekutive dhe shpenzimet e përgjithshme administrative të kryera në këtë mënyrë, qoftë në Shtetin Kontraktues ku ndodhet selia e përhershme ose diku tjetër. Megjithatë, asnjë zbritje e tillë nuk lejohet në lidhje me shumat, nëse ka, të paguara (ndryshe nga rimbursimi i shpenzimeve aktuale) nga selia e përhershme në selinë e ndërmarrjes ose në ndonjë nga zyrat e tjera të saj, me anë të tarifave të licencave, tarifave ose pagesa të tjera të ngjashme në këmbim për përdorimin e patentave ose të drejtave të tjera, ose nëpërmjet komisionit, për shërbime të veçanta të kryera ose për menaxhimin, ose, përveç në rastin e një ndërmarrjeje bankare, me anë të interesit për paratë e dhëna hua selisë së përhershme. Gjithashtu, nuk do të merret parasysh, në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme, për shumat e tarifuara (ndryshe nga rimbursimi i shpenzimeve aktuale), nga selia e përhershme në selinë e ndërmarrjes ose në ndonjë nga zyrat e tjera të saj, me anë të tarifave të licencave, tarifave ose pagesave të tjera të ngjashme në këmbim të përdorimit të patentave ose të drejtave të tjera, ose përmes komisionit për shërbime të veçanta të kryera ose për menaxhimin, ose, përveç në rastin e një ndërmarrjeje bankare, me anë të interesit mbi paratë e dhëna hua për zyrën qendrore të ndërmarrjes ose çdo selie tjetër të përhershme të saj.

4. Në masën që ishte e zakonshme në një Shtet Kontraktues për të përcaktuar fitimet që do t'i atribuoheshin një selie të përhershme në bazë të një ndarjeje të fitimeve totale të ndërmarrjes në pjesët e saj të ndryshme, asgjë në paragrafin 2 të këtij neni

nuk do të përjashtojë atë Shtet Kontraktues nga përcaktimi i fitimeve që do të tatohen nga një ndarje e tillë që mund të jetë e zakonshme; megjithatë, metoda e miratuar e ndarjes, do të jete e tillë që rezultati të jete në përputhje me parimet e përfshira në këtë nen.

5. Për qëllimet e paragrafëve të mësipërm, fitimet që do t'i atribuohen selisë së përhershme do të përcaktohen me të njëjtën metodë vit pas viti, përveç nëse ka arsye të mirë dhe të mjaftueshme për të kundërtën.

6. Kur fitimet përfshijnë zërat e të ardhurave që rregullohen veçmas në nenet e tjera të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e atyre neneve nuk do të cenohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8

Trafiku ndërkombëtar

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues nga operimi i anijeve, avionëve, hekurudhave ose mjeteve rrugore në trafikun ndërkombëtar janë të tatueshme vetëm në atë Shtet Kontraktues.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni zbatohen edhe për fitimet nga pjesëmarrja në një ortakëri, biznes të përbashkët ose agjenci operuese ndërkombëtare.

Neni 9

Ndërmarrjet e lidhura

1. Nëse:

a) një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues; ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, dhe kur në çdo rast janë caktuar ose vendosur kushte midis dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare që ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë, çdo fitim që në mungesë të atyre kushteve do t'i ishte shtuar një prej ndërmarrjeve por, për shkak të atyre kushteve nuk është shtuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe të tatohet sipas rrethanave.



2. Kur një Shtet Kontraktues përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje të atij Shteti Kontraktues dhe për rrjedhojë taton fitimet për të cilat një ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues është tatuar në atë Shtet tjetër Kontraktues dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitimet të cilat do t'i ishin shtuar ndërmarrjes së Shtetit Kontraktues të përmendur së pari, nëse kushtet e vendosura midis dy ndërmarrjeve do të kishin qenë ato që do të ishin vendosur midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë Shteti tjetër Kontraktues do të kryejë një rregullim të përshtatshëm ndaj shumës së tatimeve të vendosura në të mbi ato fitime. Në përcaktimin e këtij rregullimi, duhet t'u kushtohet vëmendje e duhur dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, nëse është e nevojshme, konsultohen me njëri-tjetrin.

3. Dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni nuk zbatohen kur procedurat gjyqësore, administrative ose juridike të tjera kanë rezultuar në një vendim përfundimtar që me veprimet që shkaktojnë rregullimin e fitimeve, sipas paragrafit 1 të këtij neni, një nga ndërmarrjet në fjalë i nënshtrohet penaltetit, në lidhje me mashtrimin, neglizhencën flagrante ose mospërmbytjen me paramendim.

Neni 10 Dividendët

1. Dividendët e paguar nga një shoqëri rezidente e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, mund të taton në atë Shtet tjetër Kontraktues.

2. Megjithatë, dividendët e paguar nga një shoqëri rezidente e një Shteti Kontraktues mund të tatonen, gjithashtu, në atë Shtet Kontraktues sipas ligjeve të atij Shteti Kontraktues por, nëse mbajtësi përfitues i dividendëve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i vendosur në këtë mënyrë nuk tejkalon:

a) 5 për qind të shumës bruto të dividendëve, nëse mbajtësi përfitues është një shoqëri (e ndryshme nga një partneritet), që mban drejtpërdrejt të paktën 10 për qind të kapitalit të shoqërisë që paguan dividendët, gjatë një periudhë 365-ditore që përfshin ditën e pagesës së dividendit (me qëllim të llogaritjes së asaj periudhe, nuk do të merren parasysh ndryshimet e pronësisë që do të rezultojnë drejtpërdrejt nga një riorganizim i korporatës, siç

është bashkimi ose riorganizimi ndarës, të shoqërisë që mban aksionet ose që paguan dividendin);

b) 8 për qind të shumës bruto të dividendëve në të gjitha rastet e tjera.

Ky paragraf nuk cenon tatimin e shoqërisë në lidhje me fitimet nga të cilat paguhen dividendët.

3. Termi “dividendë”, siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga aksionet, aksionet e minierave, aksionet e themeluesve ose të drejta të tjera që nuk janë detyrime borxhi që marrin pjesë në fitime, si dhe çdo e ardhur nga të drejta të tjera korporative që i nënshtrohet të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e Shtetit Kontraktues në të cilin shoqëria që kryen shpërndarjen është rezidente.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen nëse mbajtësi përfitues i dividendëve që është rezident i një Shteti Kontraktues zhvillon biznesin në Shtetin tjetër Kontraktues, ku shoqëria që paguan dividendët është rezidente, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të dhe që pjesëmarrja në lidhje me të cilën paguhen dividendët është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme. Në këtë rast zbatohen dispozitat e nenit 7.

5. Kur një shoqëri rezidente e një Shteti Kontraktues nxjerr fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ai Shtet tjetër Kontraktues nuk mund të vendosë ndonjë tatim mbi dividendët e paguar nga shoqëria, përveç rasteve kur këta dividendë i paguhen një rezidenti të atij Shteti tjetër Kontraktues ose për sa kohë që pjesëmarrja në lidhje me të cilën paguhen dividendët, është efektivisht e lidhur me selinë e përhershme të vendosur në atë Shtet tjetër Kontraktues, dhe as nuk do t'i nënshtrojë fitimet e pashpërndara të shoqërisë një tatimi mbi fitimet e pashpërndara të shoqërisë, edhe nëse dividendët e paguar ose fitimet e pashpërndara përbëhen tërësisht ose pjesërisht prej fitimeve ose të ardhurave të nxjerra në atë Shtet tjetër Kontraktues.

Neni 11 Interesi

1. Interesi i lindur në një Shtet Kontraktues dhe i paguar një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, mund të taton në atë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, interesi që lind në një Shtet Kontraktues mund të taton edhe në atë Shtet Kontraktues sipas ligjeve të atij Shteti Kontraktues, por nëse mbajtësi përfitues i interesit është rezident



i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i vendosur nuk tejkalon 10 për qind të shumës bruto të interesit.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni, interesi që lind në një Shtet Kontraktues do të përjashtohet nga tatimi në atë Shtet Kontraktues, me kusht që ai të rrjedhë dhe të jetë në pronësi përfituese nga:

a) Në rastin e Shqipërisë:

i. Qeveria e Republikës së Shqipërisë;

ii. autoritetet lokale;

iii. Banka e Shqipërisë (Banka Kombëtare e Shqipërisë).

b) Në rastin e Republikës sllovae:

i. Qeveria e Republikës sllovae;

ii. autoritetet lokale;

iii. Národná banka Slovenska (Banka Kombëtare e Sllovakisë);

iv. Eximbanka SR (Banka Eksport-Import e Republikës Sllovae);

v. Slovenská záručná a rozvojová banka a.s., (Banka sllovae për Garancinë dhe Zhvillimin);

vi. Agentúra pre riadenie dlhu a likvidity (Agjencia e Menaxhimit të Borxhit dhe Likuiditetit).

4. Termi “interes”, siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga detyrimet e borxhit të çdo lloji, i siguruar apo jo me hipotekë dhe pavarësisht nëse mban apo jo të drejtën për të marrë pjesë në fitimet e debitorit dhe, në veçanti, të ardhurat nga letrat qeveritare me vlerë dhe të ardhurat nga obligacionet ose dëftesat e borxhit, duke përfshirë primet dhe çmimet që u bashkëngjiten këtyre letrave me vlerë, obligacioneve ose dëftesave të borxhit. Tarifat e penaltiteve për vonesën në pagesë nuk konsiderohen interes për qëllimin e këtij neni.

5. Dispozitat e paragrafeve 1, 2 dhe 3 të këtij neni nuk zbatohen nëse mbajtësi përfitues i interesit që është rezident i një Shteti Kontraktues, zhvillon biznesin në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin lind interesi, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të dhe pretendimi i borxhit në lidhje me të cilin paguhet interesi është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 7.

6. Interesi konsiderohet të lindë në një Shtet Kontraktues, kur paguesi është rezident i atij Shteti. Megjithatë, nëse personi që paguan interesin, qoftë rezident i një Shteti Kontraktues apo jo, ka në një Shtet Kontraktues një seli të përhershme, në lidhje me të cilën ka ndodhur mbetja e borxhit mbi të cilën

është paguar interesi dhe ky interes mbulohet nga kjo seli e përhershme, atëherë interesi do të konsiderohet të lindë në Shtetin ku ndodhet selia e përhershme.

7. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe mbajtësit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shuma e interesit, duke pasur parasysh pretendimin e borxhit për të cilin paguhet, tejkalon shumën që do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe mbajtësi përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit Shtet Kontraktues, duke u kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Tarifat e licencave

1. Tarifat e licencave të i lindura në një Shtet Kontraktues dhe të paguara një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë Shtet tjetër Kontraktues.

2. Megjithatë, tarifat e licencave që lindin në një Shtet Kontraktues mund të tatohen, gjithashtu, në atë Shtet Kontraktues sipas ligjeve të atij Shteti, por nëse pronari përfitues i tarifave të licencave është një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i vendosur nuk tejkalon 8 për qind të shumës bruto të tarifave të licencave.

3. Termi “tarifë e licencave” siç përdoret në këtë nen nënkupton pagesa të çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin, ose të drejtën e përdorimit të ndonjë të drejtë autori të veprës letrare, artistike ose shkencore, duke përfshirë filmat e kinematografisë, dhe filmat ose kasetat për transmetim në televizion ose radio dhe mjete të tjera të riprodhimit të imazhit dhe tingullit dhe çdo patentë, markë tregtare, dizajn ose model, plan, formulë sekrete ose proces, softuer ose për përdorim të së drejtës për të përdorur pajisje tregtare, shkencore ose industriale (duke përfshirë anije, avionë, hekurudhë ose mjete rrugore dhe kontejnerë) ose për informacion, në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore.

4. Dispozitat e paragrafeve 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen nëse mbajtësi përfitues i tarifave të licencave që është rezident i një Shteti Kontraktues, zhvillon biznesin në Shtetin tjetër Kontraktues në të



cilin lindin tarifat e licencave, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të dhe e drejta ose prona për të cilën paguhen tarifat e licencave është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 7.

5. Tarifat e licencave konsiderohen se lindin në një Shtet Kontraktues, kur paguesi është rezident i atij Shteti Kontraktues. Megjithatë, nëse personi që paguan tarifat e licencave, qoftë rezident i një Shteti Kontraktues apo jo, ka në një Shtet Kontraktues një seli të përhershme, në lidhje me të cilin ka ndodhur detyrimi për të paguar tarifat e licencave dhe këto tarifa të licencave mbulohen nga kjo seli e përhershme, atëherë tarifat e licencave do të konsiderohen të lindin në Shtetin Kontraktues ku ndodhet selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe mbajtësit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shumat e tarifave të licencave, duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën ose informacionin për të cilin paguhen, tejkalojnë shumën që do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe mbajtësi përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit Shtet Kontraktues, duke u kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13

Fitimet e kapitalit

1. Fitimet që rrjedhin nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të referuar në nenin 6 dhe të vendosur në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme që përbën pjesë të pasurisë së biznesit të një selie të përhershme që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues, duke përfshirë fitime të tilla nga tjetërsimi i kësaj selie të përhershme (vetëm ose me të gjithë ndërmarrjen), mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

3. Fitimet e marra nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i anijeve, avionëve, hekurudhave ose mjeteve rrugore, të operuar në trafik ndërkombëtar nga tjetërsimi i këtyre anijeve, avionëve, hekurudhave ose mjeteve rrugore ose

pasuri të luajtshme që lidhen me funksionimin e këtyre anijeve, avionëve, hekurudhave ose mjeteve rrugore, tatohen vetëm në atë Shtet Kontraktues.

4. Fitimet e marra nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i aksioneve ose i interesave të ngjashëm, të tilla si interesat në një partneritet ose trust, mund të tatohen në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse, në çdo kohë gjatë 365 ditëve që i paraprinë tjetërsimit, këto aksione ose interesa të ngjashëm që rrjedhin më shumë se 50 për qind të vlerës së tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga prona e paluajtshme e vendosur në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në atë Shtet tjetër Kontraktues.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo prone tjetër, përveç asaj të përmendur në paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues, rezident i të cilit është tjetërsuesi.

Neni 14

Të ardhurat nga punësimi

1. Sipas dispozitave të neneve 15, 17 dhe 18, rrogat, pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme që rrjedhin nga një rezident i një Shteti Kontraktues, në lidhje me një punësim tatohen vetëm në atë Shtet Kontraktues, përveç nëse punësimi ushtrohet në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse punësimi ushtrohet, ky shpërblim që rrjedh prej tij mund të tatohet në atë Shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, shpërblimi që rrjedh nga një rezident i një Shteti Kontraktues, në lidhje me një punësim të ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues tatohet vetëm në Shtetin e përmendur së pari, nëse:

a) marrësi është i pranishëm në Shtetin tjetër Kontraktues për një periudhë ose periudha që nuk i kalojnë në total 183 ditë brenda çdo periudhe dymbëdhjetëmuajore, që fillon ose mbaron në vitin kalendarik në fjalë; dhe

b) shpërblimi paguhet nga ose në emër të një punëdhënësi që nuk është rezident i Shtetit tjetër; dhe

c) shpërblimi nuk mbulohet nga një seli e përhershme që punëdhënësi ka në Shtetin tjetër; dhe

3. Termi “punëdhënësi” i përmendur në nënparagrafin “b” të paragrafit 2 të këtij neni nënkupton çdo person që jep udhëzime dhe urdhra lidhur me kryerjen e punës dhe merr përsipër rrezik dhe përgjegjësi për punën e kryer.



4. Pavarësisht nga dispozitat e mëparshme të këtij neni, shpërblimi i marrë nga një rezident i një Shteti Kontraktues, në lidhje me një punësim, si anëtar i plotësimi të rregullt të një anijeje, avioni, hekurudhe ose mjeti rrugor, që ushtrohet në bordin e një anijeje, avioni, hekurudhe ose mjeti rrugor, të operuar në trafikun ndërkombëtar, përveç atyre në bordin e një anijeje, avioni, hekurudhe ose mjeti rrugor të operuar vetëm brenda Shtetit tjetër Kontraktues, tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues të përmendur së pari.

Neni 15 Tarifat e drejtorëve

Tarifat e drejtorëve dhe pagesa të tjera të ngjashme, që rrjedhin nga një rezident i një Shteti Kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtorëve ose ndonjë organ tjetër i ngjashëm i një shoqërie që është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

Neni 16 Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht nga dispozitat e nenet 7 dhe 14, të ardhurat që rrjedhin nga një rezident i një Shteti Kontraktues si argëtues, të tilla si teatër, film, artist në radio ose televizion, ose muzikant, ose si sportist, nga aktivitetet personale të këtij rezidenti, si të tilla të ushtruara në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat në lidhje me aktivitetet personale të ushtruara nga një argëtues ose një sportist që vepron si i tillë nuk i takojnë argëtuesit ose sportistit por një personi tjetër, ato të ardhura, pa marrë parasysh dispozitat e nenet 7 dhe 14, mund të tatohen në Shtetin kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e argëtuesit ose sportistit.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga aktivitetet e ushtruara në një Shtet Kontraktues, nëse vizita në atë Shtet Kontraktues mbështetet tërësisht ose kryesisht nga fondet publike të Shtetit tjetër Kontraktues, një nënndarje politike, autoritet lokal i tij. Në një rast të tillë, të ardhurat ose fitimet tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues, në të cilin argëtuesi ose sportisti është rezident.

Neni 17 Pensionet

Sipas dispozitave të paragrafit 3 dhe 4 të nenit 18, pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme, duke pasur parasysh punësimin e kaluar të paguar një rezidenti të një Shteti Kontraktues tatohen vetëm në atë Shtet Kontraktues.

Neni 18 Shërbimi qeveritar

1. Rrogat, pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të paguara një individ nga një Shtet Kontraktues ose një nënndarje politike ose autoritet lokal i tij, në lidhje me shërbimet e dhëna atij Shteti Kontraktues ose nënndarjeje ose autoriteti tatohen vetëm në atë Shtet Kontraktues.

2. Megjithatë, këto rroga, paga dhe shpërblime të tjera të ngjashme do të tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse shërbimet kryhen në atë Shtet Kontraktues dhe individ është rezident i atij Shteti Kontraktues, i cili:

- i. është shtetas i atij Shteti Kontraktues; ose
- ii. nuk është bërë rezident i atij Shteti Kontraktues vetëm për qëllimin e dhënies së shërbimeve.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, pensioni dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të paguara një individ nga, ose nga fondet e krijuara nga një Shtet Kontraktues ose një nënndarje politike ose autoritet lokal i tij, në lidhje me shërbimet e dhëna atij Shteti Kontraktues ose nënndarjeje ose autoriteti tatohen vetëm në atë Shtet Kontraktues.

4. Megjithatë, një pension i tillë dhe shpërblime të tjera të ngjashme tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse individ është rezident, dhe shtetas i atij Shteti Kontraktues.

5. Dispozitat e neneve 14, 15, 16 dhe 17 zbatohen për rrogat, pagat, pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme, për sa u përket shërbimeve të dhëna, në lidhje me një biznes të kryer nga një Shtet Kontraktues ose një nënndarje politike ose autoritet lokal i tij.



Neni 19

Profesorët dhe studentët

1. Një individ i cili, me ftesë të një Shteti Kontraktues ose të një universiteti, kolegj, shkolle, muzeu ose institucioni tjetër kulturor ose arsimor të atij Shteti Kontraktues ose sipas një programi zyrtar të shkëmbimit kulturor, viziton atë Shtet Kontraktues për një periudhë jo më shumë se dy vjet, për qëllimin e vetëm të mësimdhënies, ligjërimit ose angazhimit në kërkime në atë institucion dhe i cili është, ose ishte menjëherë para asaj vizite, rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, përjashtohet nga tatimi në Shtetin Kontraktues të përmendur së pari për shpërblimin për një veprimtari të tillë, me kusht që një shpërblim i tillë të lindë nga ai jashtë atij Shteti Kontraktues.

2. Pagesat që një student ose praktikant biznesi, i cili është ose ishte menjëherë para se të vizitonte një Shtet Kontraktues rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, dhe i cili është i pranishëm në Shtetin Kontraktues të përmendur së pari vetëm për qëllimin e arsimimit ose të trajnimit të tij për qëllimin e mbajtjes, arsimimit ose trajnimit të tij nuk tatohen në atë Shtet Kontraktues, me kusht që këto pagesa të lindin nga burime jashtë këtij Shteti Kontraktues.

Neni 20

Të ardhura të tjera

1. Zërat e të ardhurave të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, kudo që lindin, të cilat nuk trajtohen në Nenet e mësipërme të kësaj Marrëveshjeje, tatohen vetëm në atë Shtet Kontraktues.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij Neni nuk zbatohen për të ardhurat, përveç të ardhurave nga pasuria e paluajtshme, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 6, nëse marrësi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të, dhe e drejta ose prona për të cilën paguhet të ardhurat efektivisht lidhen me një seli të tillë të përhershme. Në një rast të tillë, zbatohen dispozitat e nenit 7.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij NENI, zërat e të ardhurave të një rezidenti të një Shteti Kontraktues që nuk trajtohen në nenet e mësipërme të kësaj Marrëveshjeje dhe që lindin në Shtetin tjetër Kontraktues, gjithashtu, mund të tatohen në atë Shtet tjetër Kontraktues.

Neni 21

Eliminimi i tatimit të dyfishtë

1. Kur një rezident i një Shteti Kontraktues siguron të ardhura të cilat mund të tatohen në Shtetin tjetër Kontraktues, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje (përveç në masën që këto dispozita lejojnë tatimin nga ai Shtet tjetër Kontraktues, vetëm sepse të ardhurat janë, gjithashtu, të ardhura të nxjerra nga një rezident i atij Shteti Kontraktues), Shteti Kontraktues i përmendur së pari do të lejojë si zbritje nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në atë Shtet tjetër Kontraktues.

Megjithatë, në çdo rast kjo zbritje nuk duhet të tejkalojë atë pjesë të tatimit mbi të ardhurat, siç llogaritet para se të jepet zbritja, e cila i atribuohet, sipas rastit, të ardhurave që mund të tatohen në Shtetin tjetër Kontraktues.

2. Kur në përputhje me ndonjë dispozitë të Marrëveshjes, të ardhurat e siguruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues përjashtohen nga tatimi në atë Shtet Kontraktues, ky Shtet Kontraktues megjithatë, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat e mbetura të një rezidenti të tillë, mund të marrë parasysh të ardhurat e përjashtuara.

Neni 22

Mosdiskriminimi

1. Shtetasit e një Shteti Kontraktues nuk i nënshtrohen në Shtetin tjetër Kontraktues ndonjë tatimi ose kërkesë që lidhet me të, e cila është tjetër ose më e rëndë sesa tatimi dhe kërkesat e lidhura, ndaj të cilave shtetasit e atij Shteti tjetër Kontraktues në të njëjtat rrethana, veçanërisht në lidhje me vendbanimin, janë ose mund t'i nënshtrohen.

2. Personat pa shtetësi, të cilët janë rezidentë të një Shteti Kontraktues, nuk do t'i nënshtrohen në asnjë prej Shteteve Kontraktuese ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, e cila është tjetër ose më e rëndë se tatimi dhe kërkesat e lidhura me të cilat shtetasit e Shtetit Kontraktues të interesuar në të njëjtat rrethana, veçanërisht në lidhje me vendbanimin, janë ose mund t'i nënshtrohen.

3. Tatimi mbi një seli të përhershme që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues nuk vendoset në mënyrë më pak



të favorshme në atë Shtet tjetër Kontraktues, sesa tatimi i vendosur ndërmarrjeve të atij Shteti tjetër Kontraktues që kryejnë të njëjtat veprimtari. Kjo dispozitë nuk interpretohet se detyron një Shtet Kontraktues t'u japë rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues ndonjë ndihmë personale, lehtësim dhe ulje për qëllime të tatimit, për shkak të statusit civil ose përgjegjësiwe familjare që u jep rezidentëve të vet.

4. Me përjashtim të rastit kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, paragrafit 7 të nenit 11, ose paragrafit 6 të nenit 12, interesi, tarifat e licencave dhe disbursimet e tjera të paguara nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues zbriten, me qëllim përcaktimin e fitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, në të njëjtat kushte sikur t'i ishin paguar një rezidenti të Shtetit Kontraktues të përmendur së pari.

5. Ndërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilit është në pronësi të plotë ose të pjesshme ose kontrollohet, drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk i nënshtrohen në Shtetin Kontraktues të përmendur së pari ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, e cila është tjetër ose më e rëndë sesa tatimi dhe kërkesat e lidhura me të, ndaj të cilave mund të jenë objekt ndërmarrje të tjera të ngjashme të Shtetit Kontraktues të përmendur së pari.

6. Ky nen zbatohet për tatimet që mbulohen nga kjo Marrëveshje.

Neni 23

Procedura e marrëveshjes së ndërsjellët

1. Kur një person merr parasysh se veprimet e njërit ose të dy Shteteve Kontraktuese i sjellin ose do t'i sjellin tatim jo në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga mjetet juridike të parashikuara nga ligji i brendshëm i atyre Shteteve Kontraktuese, ai mund të paraqesë çështjen e tij tek autoriteti kompetent i Shtetit Kontraktues ku ai është rezident ose, nëse çështja e tij është sipas paragrafit I të nenit 22, tek autoriteti kompetent i Shtetit Kontraktues ku ai është shtetas. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetësh nga njoftimi i parë i veprimit që rezulton në tatim jo në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes.

2. Autoriteti kompetent bën përpjekje, nëse kundërshtimi i rezulton i justifikuar dhe nëse nuk mund të arrijë një zgjidhje të pranueshme, të zgjidhë çështjen me marrëveshje të ndërsjelle me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me qëllim shmangien e tatimit që nuk është në përputhje me Marrëveshjen. Çdo marrëveshje e arritur do të zbatohet pavarësisht nga ndonjë kufizim kohor në ligjin e brendshëm të Shteteve Kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese bëjnë përpjekje të zgjidhin me marrëveshje të ndërsjellë çdo vështirësi ose dyshim që lind lidhur me interpretimin ose zbatimin e Marrëveshjes. Ata, gjithashtu, mund të konsultohen bashkërisht për eliminimin e tatimit të dyfishtë, në rastet që nuk parashikohen në Marrëveshje.

4. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri-tjetrin, për qëllimin e arritjes së një marrëveshjeje sipas paragrafëve të mësipërm.

Neni 24

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese shkëmbejnë informacione të tilla që parashikohen të jenë të rëndësishme për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje ose për administrimin ose zbatimin e ligjeve të brendshme në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimin e vendosur në emër të Shteteve Kontraktuese, ose të nënndarjeve të tyre politike ose autoriteteve lokale, në masën që tatimi mbi të nuk është në kundërshtim me Marrëveshjen. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2.

2. Çdo informacion i marrë sipas paragrafit 1 të këtij neni nga një Shtet Kontraktues trajtohet si sekret në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë, sipas ligjeve të brendshme të atij Shteti dhe u njoftohet vetëm personave ose autoriteteve (duke përfshirë gjykatat dhe organet administrative) që lidhen me vlerësimin ose heqjen, zbatimin ose ndjekjen penale, për sa i përket përcaktimit të ankesave në lidhje me tatimet e referuara në paragrafin 1 të këtij neni, ose mbikëqyrjen e sa më sipër. Këta persona ose autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata mund të zbulojnë informacionin në procedimet gjyqësore publike ose në vendimet gjyqësore. Pavarësisht nga sa më sipër, informacioni i marrë nga një Shtet



Kontraktues mund të përdoret për qëllime të tjera kur një informacion i tillë mund të përdoret për qëllime të tilla të tjera sipas ligjeve të të dyja shteteve dhe autoriteti kompetent i Shtetit që jep informacionin autorizon një përdorim të tillë.

3. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk interpretohen se vendosin ndaj një Shteti Kontraktues detyrimin:

a) të kryejë masa administrative në kundërshtim me ligjet dhe praktikën administrative të atij ose të Shtetit tjetër Kontraktues;

b) të sigurojë informacion që nuk mund të merret sipas ligjeve ose gjatë ecures normale të administrimit të atij ose të Shtetit tjetër Kontraktues;

c) të sigurojë informacion, i cili do të zbulonte ndonjë sekret tregtar, biznesi, industrial, tregtar ose profesional ose proces tregtar, ose informacion, zbulimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendi publik).

4. Nëse informacioni kërkohet nga një Shtet Kontraktues në përputhje me këtë nen, Shteti tjetër Kontraktues do të përdorë masat e tij të mbledhjes së informacionit për të marrë informacionin e kërkuar, edhe pse ai Shtet tjetër Kontraktues mund të mos ketë nevojë për një informacion të tillë për qëllimet e tij tatimore. Detyrimi që përfshihet në fjalinë pararendëse u nënshtrohet kufizimeve të paragrafit 3 të këtij neni, por në asnjë rast këto kufizime nuk interpretohen se lejojnë një Shtet Kontraktues të refuzojë të sigurojë informacion, vetëm sepse nuk ka interes të brendshëm në një informacion të tillë.

5. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni nuk interpretohen se lejojnë një Shtet Kontraktues të refuzojë të japë informacion vetëm sepse informacioni mbahet nga një bankë, institucion tjetër financiar, person i caktuar ose person që vepron në një agjenci ose në cilësinë e një fiduciari ose për shkak se ka lidhje me interesat e pronësisë të një person.

Neni 25

Anëtarët e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore

Privilegjet fiskale të anëtarëve të misioneve diplomatike ose posteve konsullore, sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta nuk cenohen në këtë Marrëveshje.

Neni 26

Parandalimi i abuzimit me traktatet

Pavarësisht nga dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje, një përfitim sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të jepet në lidhje me një zë të ardhurash, nëse është e arsyeshme konkludohet, duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat përkatëse, që marrja e këtij përfitimi ishte një nga qëllimet kryesore të çdo marrëveshjeje ose transaksioni që rezultoi drejtpërdrejt ose tërthorazi në atë përfitim, përveç nëse përcaktohet se dhënia e këtij përfitimi në këto rrethana do të ishte në përputhje me objektin dhe qëllimin e dispozitave përkatëse të kësaj Marrëveshjeje.

Hyrja 27

Hyrja në Fuqi

Kjo Marrëveshje ratifikohet në përputhje me procedurat e brendshme ligjore të të dyja Shteteve Kontraktuese dhe hyn në fuqi ditën e parë të muajit të tretë pas datës së marrjes së notës diplomatike që konfirmon se janë përfunduar procedurat e brendshme ligjore. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje kanë efekt në të dyja Shtetet Kontraktuese

a) në lidhje me tatimin e mbajtur në burim, mbi shumat e të ardhurave të paguara ose të kredituara në datën pas datës 1 janar, në vitin kalendarik pas vitit kur kjo Marrëveshje hyn në fuqi;

b) në lidhje me tatimet e tjera, ndaj tatimeve të tilla që do të vendosen për çdo periudhë tatimore, që fillon më ose pas datës 1 janar, në vitin kalendarik pas vitit kur kjo Marrëveshje hyn në fuqi.

Neni 28

Përfundimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar derisa të përfundojë nga një Shtet Kontraktues.

2. Secili Shtet Kontraktues mund të përfundojë Marrëveshjen, nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke njoftuar me shkrim mbi përfundimin të paktën gjashtë muaj para fundit të çdo viti kalendarik, pas periudhës prej të paktën pesë vjetësh nga data kur Marrëveshja hyn në fuqi. Në një rast të tillë, Marrëveshja pushon së pasuri efekt në të dyja Shtetet Kontraktuese:



a) në lidhje me tatimin e mbajtur në burim, mbi të ardhurat e paguara ose të kredituara më ose pas datës 1 janar në vitin e ardhshëm kalendarik pas vitit kur është dhënë njoftimi;

b) në lidhje me tatimet e tjera, për çdo vit tatimor që fillon më ose pas datës 1 janar në vitin e ardhshëm kalendarik pas vitit kur është dhënë njoftimi.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar sipas rregullave, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në dy kopje në Bratislavë më 30.5.2023, në gjuhët shqipe, sllovaqe dhe angleze. Në rast mospërputhjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
SLLOVAKE

DEKRET

Nr. 261, datë 2.10.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 73/2023, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë për eliminimin e tatimit të dyfishtë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe parandalimin dhe shmangien e evazionit tatimor”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM

Nr. 14, datë 28.9.2023

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, të kreut I, nenit 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdher urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, i ndryshuar, me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023 ‘Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 14, datë 28.9.2023, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Fondi Instituti, Bazat teorike të shërbimit sekret të OSSH-së, me 4 volume në total me 585 (pesëqind e tetëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara, është:

- Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së, të bëjë evidentimet përkatëse në regjistrë, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.



3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar , t'i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuara në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOMISIONIT
TË DEKLASIFIKIMIT
DHE ZHVLERËSIMIT
Gentiana Sula

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me vendimin nr. (1185)-234, datë 19.12.2022, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Ylli Braho, i datëlindjes 9.10.1943, lindur dhe banues në Pogradec, dhe caktimin e kërkueses, Pranvera Braho, si kujdestare për administrimin e pasurisë në emër të shtetasit Ylli Braho.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë